



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva
Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport



TEATRI/THEATRE
AVDUSH HASANI

Shpallë

KONKURS

Për aktorë rezident në Teatrin e Qytetit "Avdush Hasani"

Bazuar në Nenin 16 të Ligjit për Teatrot Nr. 04/L – 106 dhe Statutit të Teatrit Nenin 20 për Funkcionimin e Ansamblit të Teatrit të Qytetit, Teatri "Avdush Hasani" shpallë Konkurs publik për pranimin e aktorëve në Ansamblin Rezident të Aktorëve të Teatrit "Avdush Hasani".

Institucioni: DKRS/ Teatri "Avdush Hasani"

Titulli i punës: Aktor/Aktore (6 pozita)

Koeficienti: 7

I përgjigjet: Drejtorit të Përgjithshëm

Orari i punës: 40 orë në javë

Detyrat:

- Të mësoj tekstin dhe të mbajë prova;
- Të hulumtojë dhe lexojë material apo të ndërmarrë aktivitete fizike dhe intelektuale që ndihmojnë në përgatitjen e rolit të tij
- Të diskutojë interpretimin dhe të shfaq kreativitet në bashkpunim me të tjerët dhe regjisorin;
- Të përformoj drejtpërsëdrejti para publikut;
- Të përformojë në studio apo lokacion tjetër varësisht nga nevojat që paraqet produksioni;
- Të incizojë zëra varësisht nga nevoja e produksionit;
- Të kujdeset për hapësirën përformuese, kostumet dhe rekuizitat;
- Të mbaj mend tekstin dhe të gjitha funksionet tjera të veprës derisa ajo vepër zyrtarisht del nga repertori apo siç është e specifikuar në kontratë;
- Studion veprën dhe punon në mënyrë krijuese për jetësimin artistik në përpunimin dhe realizimin e rolit;
- Bashkëpunon drejtpërdrejt me regjisorin e shfaqjes për të rrumbullakuar rolin;
- Për punën e tij i përgjigjet regjisorit, udheheqësit artistik dhe drejtorit të përgjithshëm
- Kryen edhe punë tjera në bazë udhëzimeve të drejtorisë të teatrit.

Kushtet dhe kriteret për pranimin e aktorëve që duhen plotësuar:

- Diplomë Universitare, Fakulteti i Arteve - Drejtimi i aktrimit;
- Të dëshmojë talentin dhe përvojën e tij para audicionit që e organizon Komisioni profesional i Teatrit "Avdush Hasani"
- Të njohë gjuhën shqipe në nivel të shkëlqyer në të shkruar dhe lexuar, e domosdoshme;
- Të njohin gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Të ketë aftësi të mira për komunikime ndër-njerëzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës.
- Njohuria e punës me kompjuter, Word, Excel, duke përfshirë përpunimin e tekstit, është e preferuar

Përzgjedhja e aktorëve për ansamblin rezident bëhet përmes audicionit.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e lartë adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

Kërkesat e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit refuzohen.

Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Ligji për Teatrot Nr. 04/L – 106 dhe Rregullorja Nr. 05/2014 për Themelimin dhe Funksonimin e Ansamblit Rezident të Teatrove Kombëtare dhe Teatrove të Qyteteve.

Kohëzgjatja e emërimit: Aktorët që pranohen përmes Konkursit publik, marrin kontrata dy vjeçare me mundësi të vazhdimit, sipas suksesit dhe angazhimit të treguar.

Dokumentet e nevojshme që kërkohen:

Kandidatët duhen ti dorëzojnë dokumentet e kompletuar si vijon:

- Diplomën e Universitare
- Dëshminë mbi përvojën e punës profesionale
- Ndonjë referencë nga regjisoret apo teatrot
- Dokumenti i identifikimi
- Dëshminë që nuk jeni nën hetime

Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë (ndërtesa e re e komunës). Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni në tel. 044 274 404

Afati i dorëzimit të dokumenteve zgjatë 15 ditë, nga data: 17.06.2020 deri më datën 01.07.2020 ora: 15:00

Dt. 17.06.2020
Nr.09-111/01-28402/20



Drejtori i Teatrit të Qytetit
Agron Gërguri